



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 17, paragrafi 1, pika e të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e jashtëzakonshme, të mbajtur më 08.03.2019, miratoi këto

R e k o m a n d i m e:

1. Gjatë planifikimit të buxhetit të Komunës, të zbatohet mekanizmi për buxhetim të përgjegjshëm gjinor;
2. Të fuqizohet Zyra për barazi gjinore përmes buxhetit shtesë, të miratohet Plani gjinor i veprimit dhe të raportojë në Kuvendin e Komunës një herë në vit për punën dhe aktivitetet;
3. Të përkrahen gratë në biznes dhe subvencionimi i iniciativave lokale të grave;
4. Të bëhet formimi/fuqizimi i Komitetit për Barazi Gjinore, si trupë e Kuvendit të Komunës;
5. Të bëhet formimi/fuqizimi i mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje;
6. Të merren masa parandaluese dhe dënuese për gjuhën diskriminuese ndaj grave në institucionet lokale;
7. Të ketë raportim në baza vjetore në Kuvendin e Komunës nga KKSBJ-ja (Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi), QPS-ja (Qendra për Punë Sociale) dhe komandanti i Stacionit të Policisë, lidhur me rastet e dhunës në familje dhe jashtë saj;
8. Të ketë përkrahje financiare/subvencionim të Strehimores së viktimave të dhunës në familje dhe mbështetje për viktimat e dhunës;
9. Të bëhet identifikimi dhe përkrahja për nënat vetushqyese;
10. Të parandalohet braktisja e shkollës nga vajzat.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-011/02-59442/19, më 14.03.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

